

Date 16 / 10 / 2019

## Njoftim

Drejtuar: Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

Lënda: Kërkesë për zhvillimin e procedurës së dëgjësës me publikun

Shoqëria “Salillari” sh.p.k njofton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për zhvillimin e procedurës së informimit të publikut bazuar në VKM nr. 247, datë 30.04.2014, për aplikimin për leje mjedisi tipi B për aktivitetin:

Industria minerare ID 3.1.e: Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos dhe ID 3.10. Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jometalike, me vendndodhje në zonën kadastrale Ku-2315 në Bashkinë e Kukësit.

Ky njoftim hartohet referuar VKM nr 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt të tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar, kreu VI “Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikim për leje mjedisi të tipit A dhe B”. Bashkëlidhur gjeni përmbledhjen jo-teknike të aktivitetit.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë

“Salillari” shpk

Z. Lulzim Salillari



**PËRMBLEDHJE JO – TEKNIKE**

**EMËRTIMI I PROJEKTIT:**

**Nyje fraksionimi dhe Fabrike per prodhimin e betonit**

**VENDNDODHJA**

**BASHKIA KUKES**

**Kërkues:**

**Subjekti “SALILLARI” Sh.p.k**

**NIPT: J62903125G**



**Tirane 2019**

## Përmbledhje

<b>1. Hyrje</b> .....	4
<b>2. Vendndodhja e projektit</b> .....	4
<b>3. Përshkrim i projektit</b> .....	5
<b>4. Përshkrim i mjedisit të rajonit</b> .....	8
<b>5. Identifikimi i ndikimeve</b> .....	11
1. Ndikimet në tokë.....	11
2. Ndikimet mbi popullsinë .....	11
3. Ndikimet në ujë.....	11
4. Ndikimet në ajër.....	11
5. Ndikime në zhurma dhe vibrime.....	11
6. Ndikimet në biodiversitet.....	12
7. Mbetjet e ngurta urbane.....	12
8. Ndikime në trashëgiminë kulturore .....	12
9. Ndikime të tjera.....	12
<b>6. Masat për zbutjen e ndikimeve</b> .....	12
<b>7. Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit</b> .....	20
<b>8. Autoriteti vendimarrës për dhenien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që ndiqen</b> .....	20
<b>9. Adresa e AKM-se, ku publiku mund të dergojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 dite nga data e njoftimit.</b> .....	20

## 1. Hyrje

Shoqëria “Salillari” sh.p.k. ka selinë e vet kryesore në rrugën e vjetër Vorë – Marikaj, km 1, godina katër katëshe, kati i tretë, Nr 5 (sipas Ekstraktit të QKR). Kjo shoqëri administrohet nga Z. Lulzim Salillari dhe është e regjistruar në regjistrin tregtar me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NIPT): J62903125G me datë regjistrimi 10.08.1994. Kjo shoqëri ka nënshkruar me firmën koncensionare AHC një kontratë për punimet e mirëmbajtjes rutine dhe dimerore si dhe punime të ndertimit të autostradës Milot - Morinë.

## 2. Vendndodhja e projektit

Veprimtaria e cila përfshihet në kategorinë e aktiviteteve me ID 3.1.e. dhe 3.10 për linjë fraksionimi inertesh dhe linjë për prodhimin e betonit ndodhet në hyrje të qytetit të Kukësit, në të djathtë të Urës së Kukësit.

Objekti në aspektin gjeografik, bën pjesë në planshetën e hartës 1:25000 me nomenklaturë K-34-65-D-d dhe administrohet nga Bashkia e Kuksit.

Pika	Koordinatat	
	X	Y
1	4451389.16	4660033.81
2	4451373.82	4660049.06
3	4451353.74	4660061.37
4	4451321.3	4660054.35
5	4451290.07	4660059.3
6	4451284.59	4660031.68
7	4451295.06	4660013.01
8	4451314.65	4659998.47
9	4451344.73	4659993.03
10	4451367.54	4660008.29
11	4451382.25	4660019.13

*Sipërfaqja e kësaj zone është 5000 m<sup>2</sup>*

Objekti lidhet me rrugë të kategorisë së parë, me aksin kombëtar Tiranë – Kukës. Kjo do të jetë edhe rruga e cila do të shërbejë për kalimin e kamionëve dhe makinerive të tjera në hyrjen e kantierit që do të ndërtohet.



*Foto ajrore e zones*

Objekti, ndodhet në distancë në vijë ajrore rreth 400 - 500 m nga qyteti i Kukësit.

### **3. Përshkrim i projektit**

Subjekti “Salillari” sh.p.k do të ngrejë kantierin e ndërtimit në të cilën do të instalojë një linjë fraksionimi të inerteve dhe një linjë për prodhimin e betonit me qëllim kryerjen e punimeve sipas kontratës me kompaninë AHC.

E gjithë sipërfaqja e kantierit do të jetë e rrethuar dhe do të përfshijë zyrat, fabrikën e prodhimit të betonit dhe nyjen e fraksionimit të lëndëve të para, vendet e depozitimit të materialeve të prodhuara dhe ato të furnizuara në kantier, hapësira parkimi, etj.

Në përgjithësi një kantier përfshin:

- Vende ku janë pozicionuar makineritë dhe pajisjet teknologjike (armature tubacionet etj).
- Vende depozitimi të materialeve të ndërtimit të nevojshme.
- Hapësira parkimi për mjetet që janë jashtë funksionit
- Vendet e WC dhe të ndërrimit të cilat janë të pozicionuara në kantier dhe që do të

mirembahen dhe pastrohen rregullisht.

- Konteniere per mbetjet, materiale te rrezikshem dhe jo te rrezikshem.

Siperfaqja e kantierit do te jete e shtruar me te gjithë shtresat e nevojshme dhe do te kete nje sistem drenazhimi dhe kullimi te ujerave te shiut si dhe sistem te kanalizimeve te ujerave te zeza. Gjithashtu te gjitha ndertesat e perkohshme ne kantier do te jene te furnizuara me uje dhe energji elektrike te cilat do te sigurohen duke perdorur rrjetet ekzistuese ose do te furnizohen nga sisteme gjeneratoresh.

Materialet e ndertimit, lendet e para do te depozitohen ne vendin e posacem per depozitim dhe ruajtjen e tyre. Kjo siperfaqe ndodhet e ndare nga siperfaqja e vendosjes se nyjeve. Kjo per te siguruar edhe hyrjen dhe levizjen e makinerive te renda apo eskavatoret.

Kantieri do te pajiset me kuti te ndihmes se shpejte dhe personel te trajnuar per rastet e demtimit apo aksidenteve. Ky staf do te jete pergjegjes per nderhyrje ne rast te demtimeve te lehta dhe per ndihmen e shpejte te nevojshme ne kantier. Gjithashtu do te njoftohen qendrat mjekesore te zonave me te aferta urbane dhe do te caktohet nje grup mjekesh pergjegjes ne keto qendra per trajtimet e personelit te aksidentuar i cili do te jete ne gadishmeri 24 ore.

## **Organizimi i zyrave, fabrikave te prodhimit dhe laboratorit ne kantier**

### **Zyrat**

Zyrat do te organizohen ne menyre te tille qe te permbajne:

- I. Zyre per drejtuesin e kantierit
- II. Magazine
- III. Tualet
- IV. Kuzhine e vogel
- V. Zyrë mbledhjesh
- VI. Kontenier per pastrimin qe te jete i pajisur me:
  - Dhoma nderrimi

Gjithashtu, brenda kesaj siperfaqe do te percaktohet edhe vendi i parkimit te automjeteve, ne afersi te zyrave administrative.

### **Laboratori**

Kontraktori do te ndertoje dhe pajise me te gjitha mjetet e nevojshme nje laborator i cili do te kontrolloje gjate gjithë ecurise se punimeve cilesine e materialeve dhe ekzekutimin e punes ne perputhje me kerkesat e specifikimeve teknike dhe te projektit. DysHEMEJA e laboratorit do te jete e shtruar me beton. Laboratori do te kete ne perberje nje staf te kualifikuar dhe te mjaftueshem per te kryer te gjitha testet e nevojshme. Gjithashtu laboratori do te kete facilitetet e nevojshme dhe pajisjet e nevojshme per kryerjen, dokumentimin dhe ruajtjen e provave dhe

testeve te kryera. Hyrja ne laborator do te behet vetem nga personeli i autorizuar dhe do te ruhet gjate gjithë kohes se ekzekutimit te punimeve.

### **Procesi teknologjik i linjës së fraksionimit**

Ne kantier, do te vendoset nje impjant per perpunim e lendes se pare per prodhim inertesh me kapacitet 40 m<sup>3</sup>/ore. Impjanti do te prodhoj tre produkte: rere te lare nen 5 mm, granil te imet 5-20 mm, Granil te trashe 20-40mm. Kjo realizohet nepermjet ketyre paisjeve kryesore:

**Sita cilindrike me dy rrjeta** (perkatesisht 5 dhe 20 mm) e cila kryen sitisjen ne te laget te materialit fillestar i cili vjen ne impiant me automjet veteshkarkues dhe furnizon siten duke kaluar paraprakisht nepermjet bunkerit te depozitimit qe siguron furnizimin uniform e te vazhdueshem te sites. Uji i futur ne sitisje rrit efektivitetin e klasifikimit dhe njekohesisht ndihmon ne dispergimin e materialit te imet argjilor. Produkti nen site (-5mm) kalon me veterrjedhje ne klasifikator, fraksioni 5-20 mm dhe depozitohet ne pirc konik, ndersa produkti i trashe kokrrizor (mbi sita +20 mm) kalon ne sitisjen e dyte.

**Sita e dyte cilindrike** veçon fraksionin 20-40 mm ndersa materiali i trashe mbi 40 mm kalon ne procesin e thermimit.

**Klasifikatori spiral** realizon klasifikimin e materialit shume te imet, qe perbehet kryesisht nga argjila, nga pjesa tjetere e materialit qe perben produktin kryesor te impiantit (reren e lare). Mbiderdhja e klasifikatorit largohet me vete rrjedhje duke u shkarkuar ne lume, rera e transportuar dhe njekohesisht e c`ujezuar nga spirali (shneku) i klasifikatorit, depozitohet ne forme pircu konik.

**Thyesi me nofulla** me gryke pranimiti 400 x 600 mm, (kapaciteti orar 100m<sup>3</sup>/ore) realizon thermimin e materialit te trashe te sites duke dhene nje produkt te thermuar ne pjesen me te madhe nen 40 mm, i cili rikthehet ne procesin e sitisjes per tu perdorur me pas per shtrimin e rugeve dhe per procese te tjera ndertimore. Ky eshte edhe thyeresi kryesor.

**Tranportieri me shirit** realizon zhvendosjen e produkteve nepermjet paisjeve apo vendeve te depozitimit te produkteve.

### **Përshkrimi i procesit teknologjik: prodhimi i betonit me impiant**

Linja e teknologjisë është një linjë klasike dhe e mbyllur. Materialet inerte, depozitohen në vendin e depozitimit brenda territorit. Më pas më anë të kamionëve transportohen në bunkerët e impiantit të prodhimit të betonit. Nëpërmjet një transportieri ato transportohen tek autobetonieria, duke kaluar më parë në peshore. Peshimi bëhet në sasi të saktë të përcaktuar nga specialisti përkatës.

Cimentoja transferohet për në nyjen e betonit me kamionët me çisternë të posacme, ku ajo ruhet në sillosa dhe më pas me anë të një shneku transportohet në betoniere. Gjenden 2 sillosat e çimentos me kapacitet 50-ton çimento. Ato janë të pajisura me një filtër si dhe me sistem

tubacionesh dhe valvula. Gjithashtu gjendet depozita e ujit si dhe depozita e aditivëve. Të gjitha lëndët e para, inerte, çimento, ujë dhe aditivë, peshohen dhe hidhen në autobetoniere, në varësi të markës së betonit që duhet të prodhohet. Raporti ujë / çimento përcakton tipin e betonit si dhe vetitë kryesore si fortësia dhe qëndrueshmëria.

Në procesin e prodhimit të betonit është shumë e rëndësishme, specifike, koha e përzierjes së lëndëve të para, në mënyrë që të fitohet një masë homogjene me agregatët, ujin, cimenton dhe aditivët.

Gjatë transportimit betonieret e përziejnë gjatë gjithë kohës në mënyrë që betoni i prodhuar të jetë sa më homogjen dhe të mos ngurtësohet.

Impianti i prodhimit të betonit përbëhet nga këto njësi teknologjike funksionale:

1. **Bunkerët e depozitimit të materialit inert** të fraksionuar, sipas granulometrisë për tre fraksionet. Këta janë 3 bunkerë me vëllim prej 20 m<sup>3</sup> secili. Fraksionet që depozitohen aty janë në gjendje të lagur dhe vijnë direkt nga impianti i fraksionimit të inerteve. Bunkerët janë në formë hinke dhe të rezistueshëm nga goditjet.
2. **Peshoret e dozimit të fraksioneve.** Këto njësi matëse peshuese janë montuar në fundin e çdo bunkerit dhe në to maten dhe përcaktohen raportet e secilit fraksion, sipas qëllimeve të prodhimit për llojin e betonit.
3. **Shtrati i pritjes** dhe trasmetimi i masës së fraksioneve. Materialet inerte të ndara sipas fraksioneve me anë të transportuesit me kënd 40 gradë shkarkohen në përzierës.
4. **Silloset e cimentos** janë dy hinka metalike me kapacitet 5 ton, të cilët janë montuar në afërsi të përzierësit. Këtu mbahet tërësisht e izoluar sasia e çimentos që përziehet me materialin inert. Në fundin e këtij bunkerit gjendet një peshore që realizon dozimin përkatës të çimentos.
5. **Përzierësi i masave** është elementi i fundit i impiantit që realizon përzierjen e materialit inert dhe çimentos. Në pjesën e sipërme të tij janë montuar një sistem sitash vibruese homogjenizuese të fraksioneve që ndihmon në procesin e përzierjes. Sasia e duhur e cimentos lëshohet në përzierës nëpërmjet një hinke të posacme. Gjithashtu në përzierës është montuar dhe një sistem tubacioni që i shton masës ujë të nevojshem për lidhjen e tyre. Të gjitha materialet inerte, çimento, ujë dhe aditivë, hidhen më pas në autobetoniere ku vazhdon më tej procesi i përzierjes.

Procesi i prodhimit të betonit është tërësisht një cikël i mbyllur dhe i izoluar, me ndikim fare minimal dhe të pakonsiderueshëm në mjedis.

## 4. Përshkrim i mjedisit të rajonit

Zona e Kukësit shtrihet në pjesën verilindore të Shqipërisë. Nga veriu kufizohet me rrethin e Hasit me vijë kufitare 34 km, nga lindja me vijën kufitare 41 km nga jugu me rrethin e Peshkopisë 40 km dhe nga perëndimi me rrethin e Rrëshenit 21 km dhe të Pukës 20 km.

Rrethi i Kukësit ndodhet kryesisht në zonën e klimës mesdhetare paramalore dhe malore, nën



zona veriore dhe lindore, zonë mjaft e përshtatshme për zhvillimin ekonomik-social, turistik, sidomos dhe në zhvillimin e sporteve dimërore, ngjitjeve alpinistike, rrëshqitjeve në borë. Klima është mesdhetare malore, gjë që pasqyrohet qartë në temperaturat, karakterin dhe shpërndarjen e reshjeve, sasinë dhe formën e rënies së tyre dhe zgjatjen e shtresës së borës, erërat dhe rrezatimin diellor si dhe elementët e tjerë klimatikë. Ajo është një prej faktorëve ekologjikë që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ekuilibrin, drejtimin dhe organizimin e punëve në bujqësi, blektori dhe bimësi duke influencuar në lidhjen midis bimësisë dhe kushteve edafike.

### **Temperatura e ajrit**

Sipas vërtetimeve të fundit del se temperatura mesatare vjetore është 11.8 °C dhe amplituda vjetore 21.5 °C, që ka dhe temperaturë mesatare më të ulët, kjo për shkak të lartësisë dhe pozicionit. Maksimumi absolut i temperaturës në Kukës është shënuar në gusht 1957 që ka arritur vlerën 39.5 °C, kurse minimumi absolut është shënuar në 27 janar 1963 që ka arritur vlerat 21 °C. Periudha e vegjetacionit për bimët në këtë rreth është plotësisht e mundshme për rritjen normale të drithërave të bukës dhe të pemëve frutore, pasi dita zgjat 9-15 orë. Mesatarja faktike e temperaturës së tokës në Kukës është 13.8 °C, duke u luhatur nga 5 °C në janar deri në 22.7 °C në korrik.

### **Reshjet atmosferike**

Reshjet atmosferike në rrethin e Kukësit janë të përqëndruara më tepër në shpatet perëndimore dhe jugperëndimore të vargmaleve dhe më pak në shpatet lindore. Sasia mesatare shumëvjeçare e reshjeve në Kukës arrin shumën 946 mm, ku mbi 70% e tyre është e përqëndruar në muajt e vjeshtës dhe të dimrit (570 mm) dhe vetëm 15% gjatë stinës së verës (143 mm). Në stinën e dimrit një pjesë e reshjeve bie në formën e borës që fillon nga muaji tetor deri në prill. Trashësia e borës arrin nga 80 cm deri në 1 m. Numri i ditëve me borë arrin mesatarisht në 24 ditë, më shumë ajo zgjat në janar deri në 10.4 ditë. Breshëri në Kukës është një fenomen i rrallë dhe zgjat 1-2 ditë vetëm për pak minuta (3-5 min).

### **Era**

Erërat veriore së bashku me ato verilindore, në dimër përbëjnë 23.6% të të gjitha rasteve, në pranverë 23.3 %, në verë 22.2% dhe në vjeshtë 19.4%. Erërat lindore dhe perëndimore, të marra së bashku, në dimër dhe në vjeshtë kanë një rastisje 0.8-01.9%, kurse në verë dhe pranverë 2.2-2.8%. Kështu, Lugina e Drinit të Bardhë luan rolin e një korridori me rëndësi për hyrjen e masave ajrore të ftohta kontinentale në territorin e Shqipërisë. Shpejtësitë e mëdha të erës në orën 14<sup>oo</sup> janë rezultat i konveksionit të fuqishëm që vërehet në orën e mesditës duke arritur shpejtësinë 6.6 m/sek. Shpejtësia maksimale e erës në Kukës ka arritur vlerën 59.5m/sek, me rastisje një herë në 2.5,10,20 dhe 50 vjet.

## **Popullsia**

Popullsia e Bashkisë Kukës është rreth 16 719 banorë. Kjo popullsi është e shpërndarë në qytetin e Kukësit dhe në 14 Njësi Administrative. Ka një dendësi mesatare popullsie prej 51 banorë/km<sup>2</sup>. Vlen të theksohet se popullsia e kësaj zone me ndryshimet e sistemit ka ndryshuar shumë në numër dhe ka ardhur në zbritje si pasojë e lëvizjes së lirë demografike apo edhe migrimin ndërkombëtar. Njësi administrative me dendësi më të madhe është ajo e Shtiqen me 96 banorë/km<sup>2</sup> dhe vazhdon me Bicaj me 71 banorë/km<sup>2</sup>, e kështu me radhë. Në zonën e Kukësit vihet re dominimi i moshës së tretë si dhe një dominancë të lehtë të meshkujve në krahasim me gjininë femërore.

## **Ekonomia e zonës dhe aktivitetet ekonomike kryesore**

Rajoni i Kukësit renditet i pari për shkallën e lartë të papunësisë krahasuar me rajonet e tjera. Pjesa më e madhe e të punësuarve janë me shkollë tetë-vjecare dhe të mesme të përgjithshme dhe vetëm 14.8 % janë me shkollë të lartë. Një pjesë e konsiderueshme e banorëve janë të punësuar në qytetin e Kukësit. Dominon punësimi në sektorin e bujqësisë në Njësinë Administrative Arrën, Shishtavec dhe Topojan. Bujqësia ofron punë për pjesën dërrmuese të popullsisë ndërsa sektori privat jo bujqësor ka ndikim mjaft të ulët në punësimin e përgjithshëm. Pjesa më e madhe e të punësuarve (61%) punojnë më kohë të pjesëshme, çka lidhet edhe me natyrën rurale të zonës edhe me aktivitetin bujqësor, dhe vetëm 33.2% punojnë me kohë të plotë.

## **Hidrogeologjia dhe hidrografia e zonës**

Me termin ujëra sipërfaqësore, në sheshin e zonës së aktivitetit, do të kuptojmë reshjet e shiut që bien mbi sipërfaqen e këtij sheshi gjatë vitit. Reshjet sapo bien në kontakt me sipërfaqen e tokës lëvizin në dy rrugë kryesore, si rrjedhje mbi toke (sipërfaqësore) dhe si ujëra që infiltrojnë nën sipërfaqen e tokës që quhen ujëra nëntokesore.

Raporti ndërmjet këtyre dy rrugëve natyrisht varet nga faktorë të tillë si mbulesa vegjetale, përbërja litologjike e përshkueshmeria e shtresave, struktura gjeologjike, morfologjia e relievit etj. Gjithsesi, një gjë është e sigurt, që rrjedhja mbi sipërfaqen e tokës ndodh në ato raste kur reshjet janë intensive e të zgjatura disa ditore dhe sasia e ujit që grumbullohet në sipërfaqe është më e madhe se ajo që infiltrohet poshtë sipërfaqes.

## **Bimësia**

Vendi ku zhvillohet aktiviteti është pothuajse i zhveshur nga bimësia. Kjo për shkak edhe të relievit kodrinor por edhe të faktit që kjo sipërfaqe ka shërbyer si një kantier. Rriten vetëm pak shkurre të vogla, barishte. Të gjitha llojet e bimëve, që rriten përreth objektit janë të karakterit lokal pa ndonjë veçori dalluese dhe që nuk gëzojnë ndonjë status të vecantë mbrojtjeje. Brenda zonës së shfrytëzimit janë të zhvilluar në mënyrë të kufizuar shkurret dhe bimët locale.

## **Infrastruktura rrugore e zonës**

Infrastruktura rrugore paraqitet relativisht e mirë. Rruga që të çon në vendndodhjen e subjektit

është rruga nacionale që të con në qytetin e Kukësit.

## **5. Identifikimi i ndikimeve**

### **1. Ndikimet në tokë**

Aktiviteti që do të kryhet në kantier nuk lëshon në ambient element kimikë ose element të tjerë të dëmshëm për mjedisin. Materiali, do të depozitohet në vendin e caktuar për depozitim, brenda kantierit. Aktualisht nuk ka asnjë veprimtari industriale apo artizanale që të jetë shkak për grumbullime të dëmshme për mjedisin dhe jetën e njerëzve. Mbetjet teknologjike janë fraksione të imëta nga linja e fraksionimit të inerteve (masë e imët) që variojnë 1 – 1.5 % e sasisë së lëndës së parë të përpunuar. Mbetjet me fraksion mbi 20 mm e linjës së fraksionimit do të përdoren për mbushje dhe rievime të territorit. Kjo sasi mbetje është 5-10 % të sasisë së lëndës së parë të përdorur

### **2. Ndikimet mbi popullsinë**

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka ndikime negative mbi popullsinë përreth, përveçse do të sjellë punësimin e disa banorëve, duke kontribuar kështu sadopak në rritjen e mirëqënies së zonës përreth.

### **3. Ndikimet në ujë**

Gjatë shfrytëzimit dhe transportit, do të rritet masa e materialit të ngurtë që do të shpëlahet nga ujërat rrjedhës sipërfaqësorë, veçanërisht gjatë rënies së reshjeve. Shoqëria do të marrë masa që gjatë transportit të lëndës së parë, të evitohen ndotjet aksidentale nga derdhja e karburanteve dhe vajrave. Në zonën ku do të zhvillohet aktiviteti nuk ka lëndë helmuese apo pesticide të cilat mund të ndotin ujërat sipërfaqësore.

### **4. Ndikimet në ajër**

Përsa i përket shkarkimeve në ajër, nga zhvillimi i aktivitetit, nuk emetohen gaze të dëmshëm në atmosferë për mjedisin apo banorët e zonës përreth. Referuar natyrës së procesit nuk kemi sasi gazesh të shkarkuar në atmosferë, por vetëm grimca pluhuri. Në raste të tilla subjekti do të përdor spërkatjen me ujë herë pas here ndërsa makinat transportuese do të jenë të mbuluara me mushama. Gazet prej mjeteve të punës do të jenë në intervale kohore të shkurtra, brenda normave të lejuara pa ndonjë ndikim në mjedisin përreth. Gjithashtu duhet theksuar se linja e fraksionimit është një linjë e re e cila punon me larje të zhavorit. Ky është një faktor i cili do të ndikojë në uljen e nivelit të pluhurave. Ndërsa makinat transportuese nuk do të mbingarkohen dhe do të mbulohen me mushama.

### **5. Ndikime në zhurma dhe vibrime**

Zhurmat që do të prodhohen vijnë kryesisht nga mullinjtë e fraksionimit e të bluarjes së materialit inert i cili kalon për fraksionim e përpunim sipas permasave të dëshiruara. Gjithashtu

nje faktor tjetër ndikues janë elektromotorret e transportierëve dhe hedhja e kalimi i materialit nga një pozicion/fazë në tjetër. Nderkohe mjetet rrugore dhe zhurma e prodhuar nga vetë personat që do të punojnë për këto aktivitete, nuk vlerësohen me potencial ndikues.

Punëtorët që ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e degjimit (Kufje ose tapa për veshet). Në këto ambiente nuk vlerësohen nivele të tilla zhurme dhe si rrjedhojë edhe këto masa nuk do të jenë të nevojshme. Niveli i vibrimeve do të jetë i paperfillshëm.

## **6. Ndikimet në biodiversitet**

Zona në fjalë nuk vlerësohet si një zonë e pasur me florë dhe faunë. Vetë natyra e projektit bën që ndikimi në florën dhe faunën e zonës gjatë aktivitetit të jetë relativisht i ulët. Sidoqoftë masat mjedisore do të evitojnë ndikimet në mjedisin përreth duke influencuar në reduktimin e ndikimeve hapësinore në florën ekzistuese si dhe në faunën e pakët që ndodhet në zonë.

Speciet që do të preken nuk figurojnë ndër më të rrezikuara, të mbrojtura, endemike apo kërcënuese. Nuk ka ndikime mbi gjitarët e territorit, për shkak të uljes së numrit të tyre. Një ndikim jo të konsiderueshëm do të ketë në shpendët shtegtar që pushojnë në territor edhe pse ndikimi është në nivele të ulëta. Ndërsa ndikimi në florë do të shkaktohet nga zënia e hapësirës së kësaj prone nga rrugë-sheshe.

## **7. Mbetjet e ngurta urbane**

Mbetjet e ngurta vijnë nga: Aktiviteti human, mbetje urbane të plastikës, qelqit, metaleve etj të cilat janë të riciklueshme dhe do të hidhen në konteneret e mbetjeve urbane të zonës.

Mbetjet inerte që do të gjenerohen gjatë procesit të prodhimit do të jenë në sasi të vogla dhe ato do të grumbullohen dhe ripërdoren perseri në impiantin e prodhimit të produkteve inerte apo mund të ripërdoret për shtrim e hapsirave të pashtuara në sheshin në krah të impiantit.

## **8. Ndikime në trashëgiminë kulturore**

Në këtë zonë nuk janë dalluar objekte të trashëgimisë kulturore.

## **9. Ndikime të tjera**

Ndikimet mbi komunitetin e zonës do të jenë pozitive dhe më pak negative. Ky aktivitet ndikon pozitivisht në komunitetin e kësaj zone pasi do të krijojë mundësi për punësimin e tyre. Ndikim negativ, nga zhvillimi i këtij aktiviteti, do të ketë komuniteti pranë burimit të emetimit të pluhurave. Por ky ndikim do të jetë në nivele të moderuara dhe jo afatgjatë.

Në përgjithësi mund të thuhet se përdorimi i rrugëve të caktuara për aktivitetin e punimeve apo transportin e materialeve inerte, nuk do të ketë efekte të rëndësishme negative mbi cilësinë e rrugëve të përdorura.

## **6. Masat për zbutjen e ndikimeve**

**Masat e përgjithshme të propozuara për zbutjen e ndikimeve negative mjedisore**

Me qëllim që të parandalohen, shmangen, minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore të projektit, duhet të merren masat e duhura nga shoqëria "Salillari" shpk.

Lloji i masave për mbrojtjen e mjedisit që do të merren ndahen në:

- teknike
- organizative

#### Kuadri i masave teknike dhe organizative

Cfarë	Si
<b>Parandalim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Instalimi korrekt i makinerive sipas skemës teknologjike të përmirësuar</li> <li>• Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e përdorimit të teknologjisë dhe veprimit gjatë magazinimit dhe transportimit</li> <li>• Sipërfaqja e kantierit do të jetë vazhdimisht e lagur për shmangien e ngritjes së pluhurit gjatë aktivitetit</li> <li>• Kontroll periodik i gjendjes teknike të mjeteve të transportit</li> <li>• Zbatimi rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së saj në rast avarie të mundshme</li> <li>• Vëzhgim dhe kolaudim i vazhdueshëm i të gjithë teknologjisë së projektit</li> <li>• Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik.</li> <li>• Pajisjet dhe aparaturat do të mbahen gjithmonë të fikura, kur nuk ka procese të operimit nga aktiviteti i prodhimit të betonit dhe produkteve te inerteve</li> <li>• Mbajtja gjithmonë fikur e automjeteve gjatë procesit të ngarkimit dhe ruajtja e distances së sigurisë, gjatë operimit të punës nga punonjësit që punojne ne impiantin e prodhimit.</li> <li>• Mbajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës, si : doreza, këpucë me veshje gome, syze për mbrojtjen e syve, maska kundra gazeve dhe pluhurave, gjatë gjithë kohës dhe proceseve që zhvillohen brenda objektit.</li> <li>• Kapja dhe pastrimi i menjëhershëm në rast derdhesh të lubrifikantëve dhe grumbullimi i tyre në kontenier (fuçia) të mbyllura hermetikisht me qëllim asgjesimin e tyre përfundimtar nga kompanit e nënkontraktuar</li> <li>• Sigurim i vendit të depozitimit të mbetjeve të ngurta duke krijuar bordure të ngritura që edhe nëse rrjedhin papastërti prej tyre të qëndrojnë brenda sipërfaqes së përcaktuar, për të mos lejuar ndotje prej tyre në mjedisin përreth</li> <li>• Pastrimi periodik i vendit të depozitimit të lëndës së parë, pastrimi periodik i rrjetit të drenazimit të ujrave të shiut dhe mirëmbatja e pemëve</li> <li>• Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë</li> </ul>
<b>Kontroll</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontroll i automatizuar i të gjithë linjës së instalimit, nëpërmjet programeve inxhinierike.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sigurimi i të gjitha paisjeve të nevojshme për riparim, pastrim dhe ndërhyrje në rast emergjencash</li> <li>• Lagje e sheshit të punës dhe rrugëve të lëvizjes së kamionëve në kantier</li> <li>• Lëvizje e ngadaltë e automjeteve në kantier dhe jashtë tij</li> <li>• Larje e shpeshtë e makinerive dhe kamioneve të punës</li> <li>• Transporti i inerteve me kamion të mbuluar me mbulesë polietileni</li> <li>• Pastrimi i sheshit ku zhvillohet aktiviteti dhe atij të lëvizjes së automjeteve.</li> <li>• Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e shoqërisë ku zhvillohet aktiviteti.</li> <li>• Përdorimi me eficence i energjisë elektrike si dhe sigurimi i ambientit të objektit me ndriçimin e duhur për zhvillimin e aktivitetit.</li> <li>• Diferencimi i mbetjeve sipas rrymave specifike që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve në territorin brenda dhe jashtë objektit ku ndodhet instalimi.</li> <li>• Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.</li> </ul>
<b>Ndërhyrje</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Riparim i menjëhershëm i defekteve dhe avarive teknologjike</li> <li>• Aktivizim i menjëhershëm i stafit dhe mjeteve në rast emetimesh dhe derdhjesh të pa parashikuara sipas skemës</li> <li>• Pastrim i menjëhershëm i derdhjeve aksidentale</li> <li>• Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/aparatura nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti.</li> <li>• Kapja, asgjesimi i menjëhershëm në rastet e derdhjeve të lubrifikantëve dhe pastrimi i menjëhershëm i ambientit të punës me detërgjentë të posaçëm, që mund të gjenerohen nga linja e prodhimit dhe automjetet që kryejnë këtë shërbim.</li> <li>• Zëvendësimi i menjëhershëm të pjesëve të pajisjeve/aparaturave dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme.</li> <li>• Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar.</li> <li>• Riparimi i menjëhershëm i teknologjisë dhe linjës së prodhimit, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve.</li> <li>• Pajisja e zones së shfrytëzuar me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt.</li> <li>• Njoftim i menjëhershëm i autoriteteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (ambulance, zjarrfikës)</li> <li>• Rrethimi i perimetrit të territorit në shfrytëzim</li> </ul>
<b>Administrim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi i të gjithë infrastrukturës dhe makinerive sipas skemës dhe rregullave teknologjike</li> </ul>

## Masat për mbrojtjen e ajrit nga makineritë e transportit

Nr.	Ndikimi	Masat zbutëse
1	Pluhura dhe gaze të shkaktuara gjatë fazës së transportit	Mjetet e transportit duhet të lëvizin të mbuluara gjatë transportit të ngarkesës, duhet të pastrohen vazhdimisht nga balta para daljes së tyre nga kantieri. Nevojitet të kontrollohet vazhdimisht gjendja e tyre teknike, dhe të kryhen serviset periodike të ndërrimit të filtrave. Rugët e kantierit duhet të qëndrojnë vazhdimisht të lagura.
2	Emetim gazesh nga automjetet që do të kryejnë punimet	Sasia do të jete minimale por duhet të punohet me eficence dhe të ulët koha e mbajtjes ndezur pa qene nevoja e motoreve të mjeteve
3	Emetim zhurmash, vibracioni dhe aromash	Duhet të kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impianti për zhurmën e shkaktuar. Edhe për këtë ndikim duhet të shkurtohet në maksimum koha e mbajtjes ndezur të motorave të mjeteve.

### Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

Administrata dhe punonjësit e kantierit do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë edhe këtij aspekti për të parandaluar ndotjen në mjedis nga përhapja e mbetjeve të ngurta të gjeneruara. Në mjediset e kantierit do të vendosen kazanë të grumbullimit të mbetjeve të krijuara nga veprimtaria e kantierit. Mbetjet shoqëria do t'i dërgojë në pikën e grumbullimit të mbetjeve urbane të zonës.

### Menaxhimi i mbetjeve të gazta dhe të pluhurit

Do të merren masat e domosdoshme nga shoqëria për minimizimin e shkarkimeve në mjedis. Për këtë shoqëria do të kryejë kontrollin periodik të shkarkimeve të mjeteve të transportit që do të përdor dhe mjetet e punës si fadroma e eskavatorë.

Sheshet e kantierit do të mbahen vazhdimisht të lagura për minimizimin e ngritjes së grimcave të ngurta në atmosferë (LNP). Gjithashtu do të kryhet larja e gomave e mjeteve kur të dalin nga kantieri. Mjetet e transportit do të mbulohen me mushama.

### Vlerësimi i efektivitetit të masave zbutëse

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projekt do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës do të çojnë përfundimisht në përfitim të pamjeve të parashikuara në projekt, me sipërfaqe të pastra, të sistemuara e të gjelbëruara. Për zbatimin e projektit del i nevojshëm monitorimi dhe zbatimi i masave zbutëse. Kjo vjen si rezultat i pastërtisë teknologjike të aktivitetit. Aktiviteti i objektit dhe lidhja e tij me rrugën nacionale nuk prek zonat arkitektonike, turistike, historike, rezervat kombëtare natyrore, park kombëtar, zonë me interes shkencor, zonë me bukuri të rrallë natyrore, park rajonal e rural, zonë ujore të

mbrojtur, ndërtime me vlerë, monumente lashtësie, historike etj, sepse në afërsi të tij nuk ka zona të tilla të mbrojtura me status të vecantë. Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projekt do të varen nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar. Aktiviteti që do të kryhet, ka këto ndikime positive:

- Do të punësojë një numër të konsiderueshëm njerëzish
- Ky aktivitet nuk do të shkaktojë ndotje të ajrit, tokës, ujit të pijshëm dhe ujërave nëntokësore, se nuk do të ketë shkarkime të lëndëve të rrezikshme.
- Per zonen ku do të ndërtohet impianti do të lidhet kontrata për dhenien me qera të tokës me bashkinë Kukës.

#### **Program i rehabilitimit**

Rehabilitimi i mjedisit do të kryhet si nevojë për të kthyer burimet e prekura në gjendjen e mëparshme sa të jetë e mundur praktikisht. Mbi bazën e ndikimeve potenciale mjedisore të identifikuara do të veprohet për t'i zbutur ato. Rehabilitimi i plotë i mjedisve të territorit do të bëhet si më poshtë:

- Mbjellja e periferive të territorit që do të shfrytëzohet nga impianti i betonit dhe fraksionimit;
- Mbjellja e sheshit të impiantit me pemë në përfundim të shfrytëzimit të tyre.

#### **Program i monitorimit të ndikimeve në mjedis**

Monitorimi i mjedisit ka për qëllim që nëpërmjet matjeve sistematike, vëzhgimit, dhe raportimit të paraqesë ndryshimin e gjendjes së treguesve mjedisore. Në përgatitjen e programit të monitorimit specialistët do të marrin në konsideratë mundësinë për të realizuar një monitorim realist të elementëve me ndikim në mjedis. Gjatë zhvillimit të aktivitetit do të zbatohet një plan monitorimi për mjedisin. Ky plan do të hartohet për të monitoruar hap pas hapi të gjitha ndikimet në mjedis. Plani i monitorimit do të konsistojë në:

- Monitorimin e cilësisë së lëndës së parë;
- Monitorimin e cilësisë së ujërave nëntokësore e sipërfaqësore;
- Monitorimin e ndikimeve të veprimtarisë në mjedisin përreth dhe elementëve të tij;
- Monitorimin e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik;
- Monitorimin e nivelit të zhurmave në objekt;
- Monitorimin e nivelit të pluhurave;
- Monitorimi i mbetjeve të ngurta inerte.

Mbetjet e gjeneruara gjatë zhvillimit të procesit depozitohen në vende provizore të përcaktuara nga drejtuesi i subjektit dhe më pas në mënyrë periodike këto mbetje të ngurta largohen për në vendgrumbullimin e përcaktuar nga pushteti vendor ose ripërdoren për qëllime të ndryshme nga drejtuesi i shoqërisë.

#### **Kushtet e punës**



Përsa i përket sigurimit teknik të punonjësve ata do të jenë të mirë informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punës, konform rregulloreve përkatëse për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit. Gjithashtu shoqëria do i pajisë me uniforma dhe mjete mbrojtëse.

### **Plani i menaxhimit të mjedisit**

Cdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marrëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PMM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet, kualifikimi i personelit dhe masat mbrojtëse të përgjithshme. Duhet theksuar që menaxhimi mjedisor është në interes të të gjithëve kundrejt plotësimit të kërkesave. Duhet të zhvillohet një menaxhim mjedisor i detajuar dhe një program trajnimi.

Përbërësit kryesorë të këtij program për menaxhimin e mjedisit do të ndërthuren si më poshtë:

- Informacion i përgjithshëm;
- Mirëkuptim i informacionit të përgjithshëm i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsytet për një menaxhim mjedisor të mirë;
- Përdorimi i paisjeve/aparaturave të certifikuara sipas Standartit Europian dhe Kolaudimi periodik i paisjeve/aparaturave nga ekspertë të specializuar.
- Respektimi i orareve të punës brenda zonës ku zhvillohet veprimtaria;
- Respektimi i masave teknike të punonjësve, sipas rregullores së brendshme;
- Zhurmat do të jenë të përkohshme dhe tepër të ulëta duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, sipas Udhëzimit Nr. 8 dt 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”
- Mirëkuptimi i potencialit të ndikimeve ambientale, që mund të priten nga faza kryesore e zhvillimit të aktivitetit;
- Funksionimi;
- Arsyet për propozimin e masave zbutëse;
- Vendosja në zinxhir e përgjegjësive dhe vendimmarrja;
- Trajnime specifike;
- Monitorimi i cilësisë së ajrit;
- Kriteri për vendosjen e stacioneve monitoruese;
- Metodologjitë që duhen përdorur për fushën e marrjes së mostrave;
- Trajnime në përdorimin e paisjes dhe teknikat korrekte për ruajtjen e mostrës;
- Trajnim në laborator dhe rëndësia e cilësisë së sigurisë dhe metodat e kontrollit të cilësisë;
- Trajnim në gjetjen e mospërputhjes së situatave dhe procedurat që duhen ndjekur;
- Mjeteve që do t’iu kryhet shërbimi;
- Trajnim për inspektor/supervisor gjatë funksionimit, duke theksuar zonat kryesore mjedisore, ku duhet të përqëndrohen përpjekjet.

**Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e prodhimit të produkteve të betonit:**

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet lagia e sipërfaqeve të sheshit para objektit gjatë stinës së verës, pastrimi i vendit së depozitimit të lëndës së parë, si dhe të rrugëve komunikuese.
- Të kryhet rrethimi i objektit dhe linjës së impiantit të prodhimit dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të kryhet larja e gomave të automjeteve dhe mbulimi i tyre para daljes së tyre në rrugët e asfaltuara të zonës.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjentëve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Mbetjet inerte të Rikuperohen, Riciklohen dhe Riperdoren perseri në linjen e prodhimit, ajo sasi e mbetjeve që nuk mund të riciklohet të përdoret për mirembajtjen e sheshit para impiantit.
- Shoqëria të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM dhe MM.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruara në këtë Formular-Kërkesë për tu pajisur me Leje Mjedisore Tipi B.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoje ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesisë Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjithë kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së prodhimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

#### **Masa lehtësuese të tjera të kërkuara**

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike. Impiantet e nevojshme janë projektuar në përputhje me Ligjin e ri, nr.9379, datë 28-04-2005 “Për Eficencën Energjiesë”, kjo do të çojë në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impianit me eficientë.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.

- Subjekti të kryej aktivitetin për prodhimin e produkteve të betonit vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së tokës që disponon në pronësi.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Shfrytëzimi do të bëhet në mënyrë të tillë që të shmangë në maksimum dëmtimin e burimeve ujore, devijim e rrymave ujore, erozionin dhe dëmtimin zonave përreth.
- Linja e Impiantit të Betonit, do të koloaudohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve prodhimit të betonit.
- Mbetjet e reres, granil, me granumelometri të vogël të gjeneruara nga proceset e punës për prodhimin e betonit, do të grumbullohen në vendin e caktuar nga firma dhe mbas plotësimit të një sasive të konsiderueshme do të ripërdoren sërisht në ciklin e impiantit të prodhimit, me qëllim riciklimin dhe ripërdorimin e tyre.
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të ambalazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Do të realizohet lagja e sipërfaqes së sheshit para objektit dhe rrugët e brendshme të tij, me qëllim për të evituar ngritjen e pluhurit gjatë lëvizjes së mjeteve etj.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujit të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjediseve të gjelbëruara, një mundësi e mirë dhe për vaditje dhe shmangie të derdhjes së tyre në mjedis si dhe shmangie të përdorimit të ujit të pijshëm për vaditje. Mjedis i gjelbëruar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedisore të nevojshme.
- Rrjeti elektrik duhet të togëzohet për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Transporti i lëndës së parë do të bëhet nga mjete të pastra nga balta (gomat e automjeteve do të pastrohen para daljes në rrugë të asfaltuar).
- Zona ku do të realizohen operacioni i prodhimit të produkteve të betonit është e rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e paautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundra zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës së prodhimit.
- Aktiviteti disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksave, etj.
- Është ndertuar sistemi i drenazhimit të ujrave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Për të shmangur ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga Ujërave të Ndotura Urbane të kësaj zone do të realizohet lidhja me vaskën e dekantimit të cilat bënë dekantimin e ujrave të ndotura urbane. Ujrat grumbullohen nëpërmjet sistemit të drenazhimit të cili e përshkon të gjithë sipërfaqen e objektit ku janë të instaluar impianti/aparaturat dhe me rrjedhje të lire ujrat

drejtohen për nga puseta e dekantimit, më pas ujrën e pastra shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve të zones.

- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në impiantin e prodhimit të produkteve të betonit.

## **7. Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit**

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim të mjedisit ndërkufitar. Projekti nuk ndikon në cënimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit as të shteteve fqinjë, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore ndërkufitare, nuk ndikohet cilësia e ajrit në kontekstin ndërkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendndodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinjë.

## **8. Autoriteti vendimarrës për dhenien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që ndiqen**

Autoriteti miratues është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, e cila firmos për miratimin apo refuzimin e aplikimit për tu pajisur me leje mjedisit të tipi B, me propozim nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacionin e paraqitur nepermjet Qendres Kombëtare të Biznesit.

Afati për marrjen në shqyrtim të aplikimit për pajisjen me leje mjedisit të tipit B është 40 dite pune.

## **9. Adresa e AKM-se, ku publiku mund të dergojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 dite nga data e njoftimit.**

Faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit: [akm.gov.al](http://akm.gov.al)